

THE CENTURIES-OLD HOME OF ZYMER MUSIC IN CECELI OF VUSHTRRI SHTËPIA DISASHEKULLORE E ZYMER MUSIQIT NË CECELI TË VUSHTRISË

Jeton SALLAHU¹

¹*Corresponding author e-mail: jetoni_juve@hotmail.com

Abstrakt

Punimi studimor që e kemi trajtuar, titullohet “Shtëpia disashekullore e Zymer Musiqit në Ceceli të Vushtrisë”. Kjo do të thotë se objekti në fjalë, duke pasur ekzistencë për disa shekuj, ka vlerë të madhe kulturo-historike. Përveç ekzistencës së saj për shumëshekuj, ajo ka pasur funksione të shumëta, përçka edhe marrja me të, sikur është një domosdoshmëri. Njashtu, promovimi i këtij objekti, mund të rris edhe interesimin e vizitorëve në këtë rajon, dhe e gjithë kjo mund të “përkthehet” në rritjen e të hyrave të popullatës të këtyre anëve. Përveç këtyre që u lartëshkrua, rendësia e promovimit të kësaj shtëpie shqiptare qëndron në faktin se ajo pasqyron vlerat e ndërtimit të mjeshtërive shqiptarë, duke mos anashkaluar këtu edhe ndonjë ndikim që ka mundur me u integru nga Perandoria Osmane, apo nga ndonjë tjetër kulturë. Pastaj, fakti se në këtë shtëpi kanë jetuar shqiptarët, tregon prezencën e vazhdueshme të kësaj popullate në këto anë.

Fjalët çelësa: *Shtëpi shqiptare, disashekuj, shumëfunksione, kulturë-histori, turizëm.*

The centuries-old home of Zymer Music in Ceceli of Vushtrri

Abstract

The research paper that we have dealt with is titled “The centuries-old home of Zymer Music in Ceceli of Vushtrri”. This means that the object in question, having existed for several centuries, has great cultural-historical value. Besides its existence for centuries, it has had many functions, so dealing with it, as if it a necessity. Likewise, the promotion of this object can also increase the interest of visitors in this region, and all this can be “translated” to the increase in the incomes of the population of these countries. In addition to the above, the importance of promoting this Albanian house lies in the fact that it reflects the construction values of Albanian masters, not overlooking here any influence that may have been integrated by the Ottoman Empire, or from any other culture. Than, the fact that Albanians lived in this house, shows the continuous presence of this population in this parts.

Keywords: *Albanian house, several centuries old, multifunctional, culture-history, tourism.*

Disa informacione të përgjithshme rreth trashëgimisë kulturore vushtrriase

Në katundin Ceceli të Komunës së Vushtrisë, gjendet një objekt që mendohet se është ndërtuar para disa shekujve, megjithëse, tani objekti në fjalë, ka nevojë për intervenim profesional. Fjalën e kemi për *Shtëpinë e Zymer Musiqit*. Ç’është e vërteta Vushtria me rrethinë gjatë historisë ka qenë e begatë me trashëgimi kulturore, ndaj edhe ekzistenca e një objekti të tillë, nuk është se befason. Megjithatë, duke u ditur se edhe në Ceceli janë zhvilluar një mori luftërash, dhe dihet fakti se luftërat sjellin dëme të ndryshme, përfshirë edhe diegjen e shtëpive, e që shpeshherë nuk kursehen as ato me vlera të mëdha historike, ndaj, ekzistenca deri në ditët e sotme e *Shtëpisë së Zymer Musiqit*, është tejet e rendësishme, kur kihet parasysh se katundi në t’cilin gjendet objekti

në trajtim, kishte qenë rajon zhvillimi i luftës midis shqiptarëve dhe serbëve në fund të viteve të 90-ta të shekullit që lëmë pas. E dihet se humbësit e kësaj lufte, serbët, zakonisht, objektet me vlera historike që kishin qenë të kombësisë shqiptare, i kishin cak të sulmeve.

Në Kosovën e lirë, nga viti 1999 e tehu është fjala, megjithëse janë bërë disa punë nga profesionistët në evidentimin e objekteve arkitektonike dhe “kthimin” e tyre si mundësi e të bërit turizëm, megjithatë, krahas nevojës, arritjet nuk janë për shumë lavdërime. Kështu që, lypset një angazhim shumë më i madh në këtë drejtim, por, për tu bërë kjo, sikur është me vend ta përmendim mendimin e prezentuar në punimin studimor të specialistit të kulturës popullore, Agron Xhagollit, të titulluar *Trajtimi i mjedisit dhe kultura popullore*, i cili midis tjerash, thotë, parafrazoj: *Shkollat tona duhet ti përgjigjen nevojave të ekonomisë së tregut, duke përgatitur kuadro me njohuri rreth etnologjisë, folklorit, ngase zhvillimi i turizmit kërkon edhe menaxher të formuar*.²⁰⁵

Pra, edhe *Shtëpia e Zymer Musiqit*, apo edhe objektet e tjera arkitektonike me vlera kulturo-historike, mund të shndërrohen në atraksion për turistët, nëse do të ketë përkushtim më të madh...!Megjithatë, krahas nevojës së veprimt, mendojmë se kur bëhet fjalë për arkitekturën popullore, duhet që të kihet parasysh edhe kujdesi, ngase edhe veprimet e ngutshme, emergjente, mund të bëjnë edhe dëme, ndaj, edhe sociologu/antropologu francez Bruno Latour në një leksion të titulluar *How better to register the agency of things: Ontology* (Në gjuhën shqipe bën: Si duhet të regjistrujmë më mirë rolin e gjërave, Ontologjia) të zhvilluar në Universitetin e Yale-it më 2014, kishte deklaruar *Precisely because the situation is urgent, we need to slow down*, që do të thotë: “Pikërisht sepse situata është urgjente ose e ngutshme, duhet ta marrim me ngadalë, të mos ngutemi”.²⁰⁶

Emërtimi i objektit

Objekti që e kemi në trajtim, njihet me emrin *Shtëpia e Zymer Musiqit*, ndaj edhe shtrohet pyetja pse ky objekt njihet me një emër të tillë, dhe a njihet përherë me këtë emër?



Foto 1. Shtëpia e Zymer Musiqit nga ana e përparme²⁰⁷

Zymer Musiqi ishte një shqiptar që kishte jetuar në këto anë, dhe mendohet të ketë lindur në fillim të shekullit të XX, dhe ka vdekur kah fundi i të njetit shekull. Sipas gjasave, ai nuk ishte

²⁰⁵ Fotoja, *opcit*.

²⁰⁶ CHwB, Komuna e Vushtrrisë, *Plani lokal i trashëgimisë kulturore, Lokalni plan kulturne bastine, Local cultural heritage plan* (Prishtinë, Vushtrri, 2015, 2016), p.32.

²⁰⁷ Atë Bernardin Palaj, *Mitologji doke dhe zakone shqiptare*, përgatitur nga Anton Nikë Berisha (Shpresa, Prishtinë, 2000), p.45.

ndërtuesi i këtij objekti, por thjesht e kishte trashëguar pasurinë nga paraardhësit e tij, që do të thotë se, identifikimi i tij me objektin, nuk përkon me ndërtimin e objektit nga ai, ose nga koha e tij. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se edhe ai nuk kishte realizuar ndonjë investim në shtëpi.

Krahas emërimit të posapërmendur të shtëpisë, nuk përjashtohen mundësitë se ajo dikur ka mundur të identifikohet edhe me ndonjë tjetër emërtim, këtu e kam fjalën në radhë të parë me emrin e një Musait, respektivisht *Musa*, apo ndërkohë, edhe me ndonjë tjetër indentifikim, si *Bit*, apo *Te Bit*. Nëse do të shikonim aspektin kronologjik emërtues të objektit, atëherë, identifikimi me Musain do të duhej të ketë qenë më i hershëm, sesa dy emërtimet e tjera të përmendura.²⁰⁸



Foto 2. Shtëpia nga ana e mbrapme



Foto 3. Shtëpia nga këndi i njëres anë²⁰⁹

Koha e ndërtimit të objektit

Rreth kohës së ndërtimit të *Shtëpisë së Zymer Musiqit*, mendojmë se ende nuk është thënë fjala e fundit, megjithatë, nga hulumtimet e bëra, qoftë nga *puna në terren, materialet diskutuese me arkitektë*, apo edhe nga ndonjë *shkrim i rrallshëm i botuar*, sikur mundemi me e nxjerrë një përfundim.

Në bazë të një studimi të titulluar *Plani Lokal i Trashëgimisë Kulturore*, thuhet se *Shtëpia e Zymer Musiqit* u ndërtua në shekullin e XVII.²¹⁰

Në bazë të *kujtesës popullore hetuar nga puna në terren*, thuhet se shtëpia në fjalë u ndërtua në shekullin e XVII. Dhe para se ta sqarojmë më tutje këtë, kur jemi të ruajtja e ngjarjeve ndër brezni të shqiptarët, sikur është me vend të përmendim mendimin e studiuesit Thalloczi, i cili thotë, citoj: *Nuk ka një popull tjetër në Ballkan, as ai i Greqisë së re, që të mundet me e ndjekë historinë e fisit të vet ashtu me rend gjenealogjik, qysh prej kohërave më të lashta deri në ditët tona, si populli shqiptar.*²¹¹ Prandaj, nëse e marrim si të saktë konstatimin e studiuesit në fjalë, nuk duhet përjashtuar edhe mendimin e bartur ndër brezni të familjes Musiqi, rreth shtëpisë së tyre. Këtej, duke qenë te *kujtesa popullore*, njëri ndër pasardhësit e kësaj familje, 77 vjeçari Nazmi Musiqi, thotë se në familjen e tyre, gjithmonë ishte thënë se objekti në fjalë ishte ndërtuar

²⁰⁸ Intervistë e zhvilluar me 77 vjeçarin, Nazmi Musiqin (Katundi Ceceli, nëntor 2020).

²⁰⁹ Gjatë intervistës...*opcit.*

²¹⁰ Foto-ja u realizua nga gazetari Arlind Prenaj (Ceceli, Vushtri, 16.12.2020).

²¹¹ Edman Bello, *Materiale të pabotuara për Shtëpinë e Zymer Musiqit* (Nëntor, 2020).

në shekullin e XVII, dhe ai këtë e bazon në gjenerata, duke përmendur ekzistimin e disa Musave, respektivisht katër sosh. Nga emri, kuptojmë se popullata i takonte besimit islam (porse jo gjithëherë, ngase kishte mjaftë raste, kur vetëm i zoti i familjes ndërronte fenë për arsye ekonomike, a ndonjë tjetër, J.S.), madje njëri prej Musave, ndoshta i pari prej tyre, kishte qenë në *haxhillëk*, dhe pas kthimit, e kishin vizituar shumë njerëz, por, ndoshta jo shumë për këtë fakt, por më tepër për atë se ai kishte sjellur në shtëpi një *kafshë me gunga*, me gjasë, fjala ishte për *devenë*.²¹² Megjithatë, Nazmiu vazhdon të rrëfente se paraardhësit e tij dikur kishin qenë të krishter (megjithëse nuk ishte i sigurt i anës katolike, apo asaj ortodokse), duke kujtuar se “kishin mbajtur thi (derra, J.S.)”!²¹³ E dihet fakti se myslimanët nuk e konsumojnë mishin e thiut, anipse tek popullata shqiptare edhe këtu mund ndonjëherë të ketë përjashtime, ngase shqiptarët edhe kur kanë ndryshuar fetë, kanë ruajtur disa zakone të mëparshme, qofshin ato edhe që kishin fillësë nga religjionet e mëhershme, apo që nuk kishin të bëjnë me religjionet, porse këto të fundit ndonjëherë i kishin integruar në filozofinë e tyre.



Foto 4. Pranë këndit tjetër të shtëpisë, pritësi Nazmi Musiqi, gazetarja Egzonë Idrizi dhe studiuesi Jeton Sallahu²¹⁴

Krahas asaj që u tha deri tani në lidhje me kohëndërtimin e objektit, është me interes të skicohen edhe disa *materiale arkitektësh*. Këtu në radhë të parë e kam fjalën për arkitektin Edman Bellon. Ky i fundit, për objektin në fjalë, duke u bazuar nga teknika e punës, stili i ndërtimit, thotë se objekti u ndërtua nga popullata arbëro-shqiptare, dhe se i takon diku vitit 1600, pra në kapërcim të shekullit të XVI, respektivisht, në shekullin e XVII. Këtu, veçanarisht e ka fjalën për *katin e parë të objektit*, ngase siç thotë ai, meqenëse shtëpia ka pasur dinamizëm në

²¹² Rreth kësaj kohe, më saktësisht diku në shekujt XVI-XVII, e mendon të jetë objekti, edhe gojtari, magjistrin i renovimit të monumenteve historike, Ismet Bylykëmini, në *Disa materiale të pabotuara të Shtëpisë në Ceceli* të cilat na i dërgoi, përçka i falënderohemi. Ai, midis tjerash, thotë, kjo shtëpi dallon nga ato që ishin/ janë në qytetin e Vushtrisë, pra që ishin shtëpi me çardak (Kemer, Turqi, më 09.01.2021).

²¹³ CHwB, *Arkitektura tradicionale dhe metodat e dokumentimit, Traditional architecture and documentation methodologies* (SIDA), p.p.90-93.

²¹⁴ Grup autorësh, *Kamuni i Lekë Dukagjinit* (Shtëpia botuese “Kuvendi”, Shkodër, 2001), p.65.

veprimtari, në ndërkohë ka mundësi të ketë pasur edhe ndonjë “ndërhyrje ndërtimi” brenda objektit, pra shtim të ndonjë pjese.²¹⁵

Duke pasur parasysh këtë që përmendim deri tani, sikur na lënë të kuptojmë se objekti në trajtim i takon shekullit të XVII, megjithatë, fakti se një stil ndërtimi mund ti takon një shekulli që spikatë, por, kjo nuk do të thotë se ai stil *ndalet aty së aplikuari*, por mund të vazhdohet, të gjalloj edhe në shekujt vijues. Këtëj, sikur mund të përafrojmë kohën e ndërtimit të *Shtëpisë së Zymer Musiqit*, ndoshta duhet ta kërkojmë rreth shekujve XVII²¹⁶-XVIII.

Funksioni i Shtëpisë së Zymer Musiqit

Shqiptarët, kanë një lidhje të fort me truallin e tyre (kjo nuk do të thotë që popujt e tjerë nuk e kanë lidhjen e fort me truallin e tyre), dhe duke qenë kjo lidhje e këtitllshme, ata ndër shekuj janë munduar me gjithçka, qoftë edhe me sakrificë jete, ta ruajnë atë. Kështu, ata, krahas ndërtimeve të tjera, kanë ditur të ndërtojnë edhe shtëpi, e këto të fundit janë n’varur nga kushtet ekonomiko-shoqërore, materialet dhe teknikat e ndërtimit, mjeshtrit e ndërtimit (mjeshtrit shqiptarë-dibranë, në këtë rast dalloheshin, J.S.), klima, e të tjera.

Ndër vlerat që bota ua njehë shqiptarëve, është edhe *mikpritja*. E pikërisht vlera e posa zënë në gojë, ka të bëjë me *shtëpinë*, respektivisht, pritjen e ngrohtë të njerëzve në shtëpi, madje, kjo është sanksionuar edhe me *ligjet dokësore/kanunet*.²¹⁷ E njëri ndër këto kanune, apo njëri prej kanuneve kryesore që kishte ndikim në botën shqiptare, është ai i Lekës, respektivisht *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, i cili, në **pikën miku**, midis tjerash thotë: **Shpija e Shqyptarit asht e Zotit e e mikut**.²¹⁸

Nga kjo fjali e referuar nga kanuni i sapopërmendur më lartë, neve kuptojmë dy gjëra:

E para, se shtëpia në kulturën shqiptare ishte një lloj kulti.

E dyta, pritja e njerëzve në shtëpi, duke iu ofruar ushqim, strehim, siguri, e të tjera, ishte diçka e zakonshme.

Shtëpitë përgjithësisht, në radhë të parë, ato ndërtohen për të **banuar njerëzit**. E kjo u morë vesh se nuk bënte përjashtim as *Shtëpia e Zymer Musiqit*.

Shtëpia e Zymer Musiqit, krahas funksionit primar që kishte ajo, do të thotë të jetonin njerëzit në të, të zhvillonin jetën, madje kishte raste që në katin e parë/pjesë podrumi, mbaheshin edhe kafshët, mbase ajo kishte shërbyer edhe për funksione të tjera. E një ndër tjerat funksione që kishte kryer kjo shtëpi, diku kah fundi i Luftës së Dytë Botërore, apo pas saj, kishte qenë **një lloj zyre, që ishte shërbim të institucioneve komunale**, pasi komunistët e kishin uzorpuar atë²¹⁹

Po në atë objekt, mbahet mend se në periudhën që po flasim, ishin sjellur disa trupa të pajetë të luftëtarëve shqiptarë të atyre anëve, ballistë, të cilët luftonin për çlirimin e tokave shqiptare dhe bashkimin me Shqipërinë. Ndaj, ishin pasë thirrur familjarët e viktimave për ti identifikuar trupat.²²⁰

Si **zyre komunale**, apo si vendosës nga **këshilli i vendit**²²¹ të atij rajoni, kryenin veprim-

²¹⁵ Intervistë e zhvilluar me arsimtarin e biologjisë, ish pjestar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Bahtir Përçuku, dhe me arsimtarin tjetër, ky i fundit i TIK-ut, Ridvan Përçuku (N’kafiterinë “Çarli”, Vushtrri, më 20.11.2020).

²¹⁶ Ibid.

²¹⁷ Ibrahim Mulaku, Ferki Perçuku, *Cecelia* (Prishtinë, 2006), p.110.

²¹⁸ Foto e realizuar nga autori i këtij punimi, *opcit*.

²¹⁹ Ibrahim...*opcit*.

²²⁰ Për më shumë, shih portalin *lajmi.net* (Më 02.01.2021).

²²¹ Prezentim në video nga gjuhëtari Ferki Përçuku (Ceceli, 2019).



Foto 5. Pamje nga kati i parë, në të cilat pjesë murore lireshin gjërat ushqimore.²²²
tari në katin e dytë të objektit.²²³

Kati i parë shfrytëzohej edhe për diçka tjetër, e që ishte shumë e rëndësishme, fjalën e kam për **shkollën**, në të cilën zhvillohej mësimi në gjuhën shqipe.²²⁴ Kushtet nuk kishin qenë të mira të zhvillohej mësimi, siç tregonin edhe të moshuarit/pleqtë nëpër *oda*, ngase nxënësit nuk kishin banka, nuk kishin karrige, ndaj detyroheshin të merrnin me vete nga shtëpitë *shkamatë* për tu ulur, megjithatë, mësimi zhvillohej. Këtu rol pozitiv kishte pasur mësuesi Beqir Caka/j²²⁵, i cili lobonte që krahas djemëve, edhe femnat të ndjeknin mësimin, megjithëse numri i gjinisë së fundit të përmendur ishte më i vogël, krahasur me djemtë, dhe kjo për shkak edhe të fanatizmit fetar. Pra, kushtet për mësim ishin jo të lehta, saqë mungonin edhe shkumësat për të shkruar, e që zëvendësoheshin me gurë, duke u shkruar gurë mbi gurë, njohur si *rrasatuka*, pastaj mungonte dërrasa e zezë.²²⁶ Megjithatë, me kalim të kohës, gjendja për shkollim ishte përmisuar. Tutje, objekti, respektivisht *Shtëpia e Zymer Musiqit*, ndërkohë kishte shërbyer edhe si **shitore**, madje njihet me emër edhe shitësi i saj, fjala është për Shyqa Musiqin.²²⁷ Objekti në fjalë kishte

²²² Ibrahim...*opcit.*

²²³ Gjatë intervistës me...*opcit.*

²²⁴ Foto-ja e mësimdhënësit Beqir Caka/j u morë prej t'britit të tij, Lulzim Cakajt (07.03.2021).

²²⁵ Të dhëna të dërguara nga Lulzim Cakaj, djali i mësimdhënësit Beqir Cakajt, përçka e falënderojmë (më 13.01.2021).

²²⁶ Emin Riza, *Banesa popullore shqiptare* (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2010), p.37.

²²⁷ Selami Pulaha, *Qytetet e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës gjatë gjysmës së dytë të shek.XVI- në dritën e të dhënave të reja të regjistrimeve kadastrale osmane në revisten Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike* (IX-1979, Prishtinë, 1980), p.p.11-25.



Foto 6. Mësimdhënësi Beqir Caka/²²⁸

pasur edhe funksione të tjera përveç atyre që përmendëm deri tani.

Sikundër e shumë në gojë më lartë mësimdhënësin Cakajn (lindur rreth vitit 1920/vdekur më 1972), ndoshta e do rendi ti flasim dhe dy fjalë më shumë për të.

Zotëri Cakaj, që kishte punuar si mësimdhënësi në katundin Ceceli, respektivisht në objektin në trajtim, në ndërkohë, ai kishte punuar edhe në disa katunde të tjera. Megjithatë, ai nuk kishte qenë i lirë të ushtronte këtë profesion, prandaj edhe kishte qenë i mbikqyrur nga regjimi komunist, madje edhe i burogusur një kohë.

Për **28 Nëntor**, pra në **Festën e Flamurit të Shqiptarëve**, ai kishte shkruar pamflete me karaktere kombëtare e që regjimi nuk i lejonte, fshehur nën rroba/belit nga gruaja e tij Zylfija, dhe pastaj i kishte shpërndarë me bicikletë nëpër qytetin e Mitrovicës, gjersa ato të tepruarat ia kishte dhënë axhës së tij Jahirit të ia fshihte nën guri të një bunari/pusi të ujit në katundin Bletajë/Stanovc i Epërm.²²⁹

Objekti që e kemi në trajtim, paska rendësi **kulturo-historike ngase ekziston për disa shekuj.**

Duke pasur fjalën për objektin e folur deri këtu, ai ka pasur gjatë historisë **llojllojshmëri të funksioneve.**

Nëse objektet si kjo promovohen mëtej, mund të rrisin edhe **interesimin e vizitorëve** për këtë rajon, dhe e gjithë kjo mund të “përkthej” në rritjen e të hyrave të popullatës të këtyre anëve.

Ruajtja e këtij objekti pasqyron edhe **diturinë e mjeshtërve shqiptarë**, pa përjashtuar këtu edhe ndikimet e përfituara nga perandoritë që ishin këtej të pranishme, në këtë rast as atë osmane.

Përveç këtyre që u lartëshkruan për objektin që po e trajtojmë, ekzistenca e tij e rrok edhe një tjetër segment, **atë se paska pasur ndër shekuj një prezencë të vazhdueshme të popullatës arbnesho-shqiptare në këto anë**, duke mos përjashtuar këtu as në kohën e prezencës osmane. Dëmthënë, *Shtëpia e Zymer Musiqit* duke qenë pjesë e *arkitekturës popullore*, respektivisht e kulturës materiale, është dëshmi e prezentimit të historisë së kaluar, por edhe të sotshme të popullit shqiptar. Ndaj, edhe mendimi i studiuesit Emin Riza se Kosova ka një pasuri kulturore edhe në fushën e banesës popullore (kupto: banesë nënkupton edhe shtëpi e jo vetëm ndërtesë me shumëkate, J.S.) si në katunde ashtu dhe në qytete, të cilat dëshmojnë autoktoninë e shqiptarëve

²²⁸ Muhamet Tërnavë, *Migrimet e popullsisë në territorin e sotëm të Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI* në revistën *Kosova* (Nr.V, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1978), p.p.289-325.

²²⁹Radosllav Katçiq, *Antroponomia ilire dhe etnogjeneza e shqiptarëve* në revistën “Jehona” (2, viti XI, Shkup, 1972), p.p.68-74.

në këto troje...²³⁰ mendojmë se është i drejtë. Këtej, edhe objekti për të cilin po flasim që ndodhët në katundin Ceceli të Komunës së Vushtrrisë, duhet të shikohet në këtë kahje. Pra, në kapërcim të *mesjetës* (por dhe gjatë saj, apo dhe në kohët më të hershme), e në agim të *kohës së re*, këto territore shumicërisht në vazhdimësi banoreshin nga etnikumi arbnesho-shqiptar, pa përjashtuar këtu edhe praninë popullore të tjera pakicore. Interesante në këtë drejtim janë edhe disa rezultate të nxjerrura nga studiuesit, në këtë rast po i përmendim dy, Selami Pulahën, i cili duke shfrytëzuar dokumentacionin e administratës osmane, sidomos regjistrimet kadastrale të kryera në shekujt XV-XVI, vjen në përfundim se në qytetet e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës, mbizotëroheshin nga popullata arbnesho-shqiptare²³¹ dhe, studiuesin Muhamet Tërnavën, i cili me punimin e tij *Migrimet e popullsisë në territorin e sotëm të Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, provon se në shekujt e XIV-XVI, popullata arbneshoshqiptare kryesisht nuk përmendët si ardhacake në Kosovë, ose nëse kishte pak ardhje, ajo ishte e formës së brendapërbrendshme, fjala vjen, lëvizje nga Vushtria/Vuçitërna në Mitrovicë, apo ngjajshëm, derisa popullatë ardhacake në Kosovë, siç duket ishte ajo sllave, edhe para vendosjes së pushtetit osmano-turk, prandaj edhe kur më 1455 ishte vendosur pushteti i posapërmendur, në defterin e kësaj treve apo të Vilajetit Vëllk, (Sanxhaku i Vuçitërnit, hartuar ky i fundit me gjasë në kohën e sulltanit Selimi i Dytë, 1566-1574, por që kapte afërsisht territor të njëjtë sikurse Vilajeti Vëllk) siç ajo njihej ashtu në atë vit, gjendën kryefamiljar të cilësuar si të ardhur, *prishliç, doshllac, prisellica* (megjithëse jo të gjithë këta kryefamiljar gjithëherë duhet të shihen **sllav/serb** për nga etnosi, ngase edhe elementi etnik **arbnesho-shqiptar** dhe ai **vllëh** para kohës osmano-turke prej faktorëve religjioz-shtetëror, politik, ishte veshur me antroponomi sllave). Kështu, nëse administrata osmane njashtu i evidentonte në defterë si *doshllak, prishliq, uselica*, kjo do të thoshte se i veçonte nga populli vendës, domëthënë i veçonte nga arbneshoshqiptarët. Ngjajshëm me këtë dukuri flasin edhe defterët e tjerë të më vonshëm të shekujve të përmendur më lartë.²³²

Resume

Nga që u tha më sipër, mund të konkluzojmë rreth një pranie të vazhdueshme dominuese të etnikumit arbnesho-shqiptar në trevën që po flasim (duke përfshirë këtu edhe qytetin e Vushtrrisë, përçka na flasin edhe shënimet e shtegtarit osmano-turk, E. Çelebiut), e edhe *Shtëpia e Zymer Musiqit* është dëshmuar e këtij etnikumi. Këtej, kjo trevë nuk ishte mbushur as në fund të shekullit të XVII nga territori i sotëm i Shqipërisë Shtetërore me këtë etnos, siç një pjesë jo e vogël e historianshkruesve sllavë pretendonte e pretendon, e që edhe një pjesë e historiografisë së huaj gabueshëm e kishte përqaftuar këtë teori. Atëherë, objekti që e trajtuam paska rendësi kulturo-historike, do të thotë se ai ekziston me shekuj, e kishte kryer funksione të ndryshme, njëkohësisht shpërfaqë zotësinë e mjeshtërive shqiptarë. Ndërsa në ditët e sotme, ai mund të tërheq vizitorë nga vendet e ndryshme, duke treguar kulturën autoktone.

²³⁰Afërsisht 2400 vjet më parë, ilirët dardan e kishin pas themeluar Shtetin/Mbretërinë Dardane. Gjersa pushtuesit romak, diku në shekullin I para lindjes së krishtit, i kishin pas mposhtur ilirët dardan, megjithëse qëndrsa e këtyre të fundit kishte pas vazhduar edhe mëtej; Bëjmë me dije lexuesit se ekziston edhe një libër interesant i studiuesit Luan Përzihita me titull *Mbretëria Dardane histori e shkurtër e shtetit 2400-vjeçar* (Botaart, Tiranë, 2009).

²³¹Edi Shukriu, *Kultura materiale dardane në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të parë p.e.s* në revisten "Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike" (XIII-1983, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1984), p.p.7-11.

²³²Exhlale Dobruna-Salihu, *Mbi besimin në jetën e amshueshme në pjesën qendrore të Dardanisë në bazë të monumenteve sepulkrale* në revisten "Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike" (35, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005), p.p.355-361.

Burimet dhe literatura

I.Burimet e pabotuara

-Materiale shkrimore

- [1]. 1.Bello, Edman, [2020], Materiale të pabotuara për Shtëpinë e Zymer Musiqit.
- [2]. 2.Bylykemi, Ismet, [2021], Disa materiale të pabotuara të Shtëpisë në Ceceli.
- [3]. 3.Cakaj, Lulzim, [2021], Të dhëna të dërguara rreth Beqir Cakajt.

-Intervista

- [1]. 1.Musiqi, Nazmi, [2020], Vushtrri.
- [2]. 2.Musiqi, Nazmi, [2020], Ceceli.
- [3]. 3.Përçuku, Bahtir, [2020], Vushtrri.
- [4]. 4.Përçuku, Ridvan, [2020], Vushtrri.

-Fotografi

- [1]. 1.Cakaj, Lulzim, [2021].
- [2]. 2.Prenaj, Arlind, [2020].
- [3]. 3.Sallahu, Jeton, [2020].

II.Burimet e botuara

-Literatura

- [1]. 1.CHwB, [2015, 2016], Plani lokal i trashëgimisë kulturore, Prishtinë, Vushtrri.
- [2]. 2.CHwB, Arkitektura tradicionale dhe metodat e dokumentimit.
- [3]. 3.Grup autorësh, [2001], Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër.
- [4]. 4.Mulaku Ibrahim, Përçuku Ferki, [2006], Cecelia, Prishtinë.
- [5]. 5.Palaj, Bernardin, [2000], Mitologji doke dhe zakone shqiptare, Prishtinë.
- [6]. 6.Riza, Emin, [2010], Banesa popullore shqiptare, Tiranë.
- [7]. 7.Xhagolli, Agron, [2020], Trajtimi i mjedisit dhe kultura popullore në përmbledhsin “Trashëgimia kulturore dhe turizmi”, Gjilan.

-Revista

- [1]. 1.Luarasi, Skënder, [2015-2016], Drejt një etike të ngadalësimit dhe një estetike të ndërlikimit: një përpjekje për të regjistruar rolin e praktikave hapësirë-formuese në formë-dhënien e territorit në revisten kulturore “Përpjekja”, Tiranë.
- [2]. 2.Pulaha, Selami, [1980], Qytetet e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës gjatë gjysmës së dytë të shek.XVI-në dritën e të dhënave të reja të regjistrimeve kadastrale osmane në revisten “Gjurmime albanologjike seria e shkencave historike”, Prishtinë.
- [3]. 3.Tërnavë, Muhamet, [1978], Migrimet e popullsisë në territorin e sotëm të Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI në revistën “Kosova”, Prishtinë.

-Interneti

- [1]. 1.Përçuku, Ferki, [2019], Video, Ceceli.
- [2]. 2.Portali lajmi.net [2021].